



Pranuar / Dorezuar Prilbheno / Profilato Received / Delivered	15-09-2021	viti god year	1
Organ / Shëresa Organ / Jedinstvo Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Pufeg Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHK	1809/2021		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.167/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-Kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.2693/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 12.03.2021, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.460/2019 të datës 13.08.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Rruga "Garibaldi", P.N, Komuna e Suharekës, kundër Vendimit me numër 01-Nr.016-46023 të datës 15.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Suharekës, në çështjen administrative juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin 47 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 14.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.460/2019 e datës 13.08.2019 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër 01-Nr.016-46023 i datës 15.07.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Suharekës si dhe Njoftimi me nr. 01-Nr-016-37863 i datës 12.06.2019 për kandidatën e suksesshëm.

A r s y e t i m

Ankuesi përmes postes së Kosovës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar me datë 18.03.2019 me numër protokollit 3537/2019 e regjistruar me numër A.nr.460/2019, kundër Vendimit me numër 01-Nr.016-46023 të datës 15.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Suharekës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 15.08.2019, ka proceduar kërkesës për përgjigje në ankesë tek Komuna e Suharekës. Ndërsa Këshilli me datë 22.08.2019 ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokollit 3742 se bashku me shkresat e lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional për shkak të mos emërimit të anëtarëve nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, me ç'rast Këshilli me shkresën e datës 10.10.2019 ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës së tij me numër A.nr.460/2019 të datës 13.08.2019, duke udhëzuar palë mbi të drejtën e ndjekjes së procedurës gjyqësore në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ. Pas këtij njoftimi të Këshillit, ankuesi ka hapur konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, e cila me Aktgjykimin A.nr.2693/19 të datës 12.03.2021 i pranuar në Këshill me datë 18.03.2021, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, ka anuluar Njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 10.10.2019 dhe ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda tridhjetë (30) ditësh të vendos për ankesën e ankuesit të datës 13.08.2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesës për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 13.08.2019 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e ankuesit të datës 05.07.2019 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Suharekës; Vendimin e datës 15.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ministrisë së Financave; Konkursin e datës 02.05.2019; Autorizimin për publikimin e konkursit nga MAP/DASHC-ja i datës 30.04.2019; Njoftimin e datës 12.06.2019; Njoftimin për kandidatin e suksesshëm të datës 12.06.2019; Përgjigjen në kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 22.08.2019; Vendimin për vazhdimin e konkursit i datës 21.05.2019; Vendimin e Kryetarit të Komunës së Suharekës për themelimin e Komisioni Përzgjedhës të datës 30.05.2019; Deklaratën e datës 30.05.2019; Akt Emërimit e datës 28.12.2011; Vazhdimin e kontratës së punës së datës 24.11.2017; Vendimin e datës 17.03.2016; Akt Emërimit e datës 28.12.2011 me numër Nr.-49; Akt Emërimit e datës 10.08.2018; Akt Emërimit e datës 28.12.2011 me numër 01-Nr.48; Konkursin e publikuar në gazetën ditore "Bota Sot" i datës 03.05.2019; Regjistrin e aplikacioneve të pranuara; Njoftimin i datës 07.06.2019; Ftesën e datës 03.06.2019; Formularët për vlerësimin individual përfundimtar të kandidatëve për vendin e punës të datës 06.06.2019; Kërkesën për punësimin e ankuesit të datës 15.05.2019; Diplomën nr.557 të datës 11.03.2014; Diplomën nr.1200 të datës 17.10.2011; Vërtetimin e datës 15.03.2017; Vërtetimin e datës 25.01.2019; Vërtetimin e datës 02.07.2015; Marrëveshjen për shërbime të veçanta të datës 25.02.2019; Vërtetimin e datës 01.07.2014; Vërtetimin e Odës së Avokatëve i datës 02.10.2015; Certifikatën e datës 01.08.2004; Letër konfirmimin e datës 05.12.2011; Referencën e datës 22.02.2016; Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prizren e datës 08.05.2019; Ekstraktin nga regjistri qendror i gjendjes civile e datës 10.05.2018; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Njoftimin e datës 12.06.2019 me numër 01-Nr-78; Flete dërgesa e datës 14.06.2019; Njoftimin e datës 12.06.2019 me numër 01-Nr-73; Ftesën e datës 03.06.2019; Kërkesën për punësimin e kandidatit të përzgjedhur të datës 08.05.2019; Diplomën nr.831 e datës 04.06.2015; Certifikatën e datës 28.10.2008; Vërtetimin e datës 10.08.2017; Letër referencën e datës 10.08.2017; Vërtetim e datës 28.05.2019; Vërtetimin e lëshuar nga Oda e Avokatëve të datës 04.06.2018; Vërtetimin e datës 01.10.2018; Konfirmimin e datës 08.03.2011; Çertifikatën e datës 01.05.2015; Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prizren e datës 06.05.2019; Ekstraktin nga regjistri qendror i lindjes civili i datës 07.05.2019; Kopjen e letërnjoftimit të kandidatit të përzgjedhur; Testin me shkrim të kandidatit të përzgjedhur; Testi me shkrim të ankuesit; Raportin Final të Rekomandimit nga komisioni rekrutues i datës 12.06.2019; Formularin e përmbledhjeve të vlerësimeve individuale të datës 11.06.2019; Listën e orarit të

intervistës me gojë të datës 11.06.2019; Testin me gojë të datës 11.06.2019; Njoftimin e datës 07.06.2019 nga zyra e personelit për rezultatet e testit me shkrim; Njoftimin e datës 03.06.2019 për përfshirjen në listën e shkurt; Përcaktimin për përfshirjen në listën e shkurt; Formularin e vlerësimit individual të datës 31.05.2019 për përzgjedhjen në listën e ngushtë; Deklaratën e nënshkruara nga anëtarët e komisionit përzgjedhës për mosekzistimin e konfliktit të interesit të datës 31.05.2019, Njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës të datës 10.10.2019; Aktgjykimin numër A.nr.2693/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, e-mailat komunikues të datës 02.04.2021 fq.1,deri 4 me nr. Protokoli 1767 datë 14.02.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit _____ me numër A.nr.460/2019 e datës 13.08.2019 është e pa bazuar, *sepse*:

Bazuar në shkresat e lëndës rezulton se Komuna e Suharekës në bazë të autorizimit të datës 30.04.2019 të Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/Ministria e Administratës Publike, me datë 02.05.2019 ka shpallur konkursin me nr. 01-Nr-11-28803 për pozitën "Sekretar i Shkollës së Mesme" në Gjimnazin "Jeta e Re" i vazhduar edhe për shtatë (7) ditë për arsye të përfaqësimit etnik respektivisht deri me datë 27.05.2019. Në këtë konkurs ka aplikuar gjithsej tetë(8) kandidatë duke përfshirë edhe ankuesin _____ i cili ka marr pjesë në të gjitha fazat e vlerësimit, por që nuk ka arritur të përzgjidhet si kandidat i suksesshëm për këtë pozitë. Në listën e ngushtë të datës 03.06.2019 janë përfshirë 5 aplikues, të cilët kanë plotësuar kushtet për përfshirje në listën e ngushtë dhe të njëjtit janë ftuar për në testimin me shkrim i mbajtura me datë 06.06.2019, ndërsa në intervistën me gojë të mbajtur me datë 11.06.2019 kanë marrë pjesë tre kandidatet respektivisht _____ dhe _____ Komisioni Përzgjedhës i emëruar sipas Vendimit 01-Nr.020-350055 të datës 30.05.2019 të Kryetarit të Komunës së Suharekës, në Raportin final Nr.Ref.RN00004780 të datës 12.06.2019 ka rekomanduar _____ kandidat të suksesshëm për pozitën e Sekretarit të Shkollës së Mesme " Jeta e Re" Suharekë, me gjithsej 83.40 pikë të arritura. Bazuar në raportin final të Komisionit Përzgjedhës, Njësia e Personelit të Komunës së Suharekës ka bërë Njoftimin me nr. 01-Nr-016-37863 të datës 12.06.2019 për kandidatin e suksesshëm.

Ankuesi kundër Njoftimit Nr.01-Nr-76 të datës 12.06.2019 për mos pranimin e tij në pozitën e Sekretarit të Shkollës së Mesme " Jeta e Re" Suharekë, ka parashtruar ankesë më datë 05.07.2019 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Suharekës, i cili me Vendimin 01-Nr-016-46023 të datës 15.07.2019 ka refuzuar ankesën si të pa bazuar dhe ka lenë në fuqi Njoftimin me nr.01-Nr-016-37863 të datës 12.06.2019 të Komisionit Përzgjedhës. Kundër Vendimit të 01-Nr-016-46023 të datës 15.07.2019 të KZKA-së, ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës me pretendimin ankimor se është shkelur Ligji për shkak se për këtë pozitë katalogu i vendeve të punës të Ministrisë së Administratës Publike parasheh përvojë profesionale të punës së paku dy (2) vjeçare, ndërsa sipas konkursit është përcaktuar përvojë pune se paku tri (3) vite dhe se Komisioni Përzgjedhës ka bërë vlerësim minimal të ankuesit.

Lidhur me pretendimin ankimor se me Katalogun e Vendeve të Punës të Ministrisë së Administratës Publike, për pozitën Sekretar i Shkollës së Mesme kërkohen dy vjet përvojë pune profesionale e jo tri vite ashtu siç është përcaktuar në konkursin e datës 02.05.2019, Kolegji bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se Konkursi me nr. 01-Nr-11-28803 për

pozitën "Sekretar i Shkollës së Mesme", në Gjimnazin "Jeta e Re" është shpall nga Komuna e Suharekës bazuar në miratimin sipas Autorizimit të Departamentit për Administrimin e Shërbimit Civilë të datës 30.04.2019 dhe se kriteret e përfshira në konkurs janë tërësisht në pajtim me kriteret e aprovuara nga DASHC me Autorizimin e datës 30.04.2019.

Po ashtu, përkitazi me këtë pretendim ankimor, Këshilli me datë 02.04.2021 i është drejtuar me kërkesë (e-mail) për sqarime DASHC tani Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë, ku në njëjtën ditë Këshilli ka pranuar sqarimin dhe konfirmimin nga Drejtori i DMZP së Autorizimi për pozitën Sekretar i Shkollës së Mesme", në Gjimnazin "Jeta e Re" në Suharekë, është aprovuar nga DASHC me datë 30.04.2019 dhe se kriteret për të cilat pretendon ankuesi kanë të bëjnë me pozitën Sekretar të ciklit fillor-ulët, e jo për cikël të mesëm. Andaj, rrjedhe se pretendimi ankimor i ankuesit mbi këtë bazë është i pa bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se Konkursi me nr. 01-Nr-11-28803 për pozitën "Sekretar i Shkollës së Mesme", në Gjimnazin "Jeta e Re" është shpallur dhe ka përmbajtur të gjitha kërkesat ashtu siç është përcaktuar me nenin 15, 16 dhe 17 të Rregullores NR.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit të Shërbyesve Civilë, rrjedhimisht Konkursi pas miratimit nga DASHC-ja më datë 30.04.2019, është shpallur në mënyrë publike përmes gazetës ditore "Bota Sot", përmban informacionet siç përcaktohet me nenin 16 të kësaj Rregullore, si dhe shpallja e konkursit është bërë brenda afatit prej pesë (5) ditësh nga data e aprovimit të konkursit, respektivisht miratimi i konkursit është bërë me datë 30.04.2019, ndërsa shpallja është bërë më datë 02.05.2019.

Po ashtu nga vlerësimi i provave të lëndës, Kolegji ka gjetur se vlerësimi paraprak i kandidateve, përgatitja e listës së ngushtë si dhe procesi i vlerësimit të kandidateve janë bërë në pajtim Rregulloren NR.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit të Shërbyesve Civilë.

Për pozitën e shpallur "Sekretar i Shkollës së Mesme", në Gjimnazin "Jeta e Re" Suharekë me nr. 01-Nr-11-28803 të datës 02.05.2019, kriteret kryesore të konkursit kanë qenë:

- *Diplome Universitare-Fakulteti Juridik ose Administratë Publike dhe*
- *Tri (3) vite përvojë punë profesionale.*

Lidhur me kërkesat themelore për kualifikim arsimor dhe përvojë pune, Kolegji bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se kandidati i përzgjedhur ka plotësuar kushtet sipas konkursit dhe në dosjen e tij të aplikimit ka poseduar: Certifikatë të Universitetit të Prishtinës-Fakulteti Juridik me numër Ref. K-292/04/464 të datës 28.10.2008, më të cilin dëshmohet se ka të përfunduar Fakultetin Juridik, dhe ka marrë titullin Bachelor i Drejtësisë, Diplomë të Universitetit të Prishtinës Nr. 831 të datës 04.06.2015 me të cilën dëshmohet se ka përfunduar studimet Master drejtimi Civil- Juridik dhe ka fituar titullin Ma.Sc i Juridikut-Civil, ndërsa lidhur me përvojën e punës pas diplomimit kandidati i zgjedhur posedon: Vërtetim nga SHPK "SOLID" me të cilin konfirmohet se ka punuar në Administratë pranë kësaj Kompanie nga data 01.06.2015 deri 31.07.2017, Vërtetim nga Oda e Avokateve të Kosovës me nr. 708/2018 të datës 04.06.2018 me të cilin dëshmohet se Ymer Berisha ka kryer praktikën e Avokatit në Zyrën e Av. gjatë periudhës 05.06.2017 deri 04.06.2018, Vërtetim me Nr. Protokoll 99/01.10.2018 të lëshuar nga Drejtori i Shkollës Fillore" Suharekë, sipas të cilët ka ushtruar detyrën e Administratorit pranë kësaj shkolle nga data 01.10.2012 deri 31.03.2013, Vërtetim me nr. 62 i datës 28.05.2019 i lëshuar nga Drejtori i Shkollës Fillore" Shkëndija" Suharekë më të cilin vërtetohet se ka ushtruar detyrën e Administratorit në këtë Shkollë nga data

01.04.2013 deri 31.08.2013 si dhe Vërtetim nr.01. Nr.-45 të datës 08.03.2011 të lëshuar nga Udhëheqësi i Zyrës së Personelit të Komunës së Suharekës me të cilin konfirmohet se ka kryer praktiken në Administratën e Komunës së Suharekës-Departamenti për Administratë dhe Inspektion nga data 04.05.2010 deri 11.01.2011.

Bazuar në Raportin Final të datës 12.06.2016 nga Komisioni Përzgjedhës, kandidati është vlerësuar me 83.40 pikë, ndërsa ankuesi Ardit Gashi me 72.90 pikë, andaj mbi këtë bazë, Kolegji vlerëson se Komisioni Përzgjedhës ka vepruar në pajtim me nenin 40 paragrafi 1 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civilë ku është përcaktuar se: *në Shërbimin Civilë emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin me të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe gojë, e në këtë kuptim, pretendimi ankimor i ankuesit lidhur me vlerësim jo të drejtë është i pabazuar.*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Suharekës me rastin e vendosjes lidhur me ankesën e ankuesit të datës 05.07.2019 sipas Vendimit Nr. 01-Nr-016-46023 të datës 15.07.2019, ka konstatuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike lidhur me çështjen e kontestuar.

Andaj, duke ju referuar rrethanave dhe fakteve si me lartë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstaton se Komisioni Përzgjedhës për Shërbimin Civil lidhur me pozitën Sekretar i Shkollës së Mesme", në Gjimnazin "Jeta e Re" Suharekë, ka vepruar në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitive të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës* si dhe Rregulloren NR.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit të Shërbyesve Civilë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas analizimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.460/2019.

Flakron Gashi


Zyrtar i Lart për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit,
- Kryetarit të Komunës së Suharekës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Suharekës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.